



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**QENDRA KOMUNITARE “TË QËNDROJMË SË BASHKU”**

Nr. 183\_\_prot

Tiranë, më 29.4.2024

**PROCES – VERBAL Nr.1**

**“Për Hartimin, Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve të Veçanta për Kualifikim dhe Specifikimeve Teknike, që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik të procedurës së prokurimit me objekt:**

**FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MENCAT**

**Per periudhën 2024-2025**

I mbajtur sot më datë 29.4.2024, në Qendren Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë nga Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimit për realizimin e prokurimit me procedurë “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me objekt: “Furnizim dhe shërbime me ushqim per mencat”, me fond limit **7,956,667 (shtatëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) LEKË PA TVSH**

Në zbatim të Nenit 21 pika 1, Neni 2, pika 2 c), Neni 33, Neni 41, pika 1 ë) dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020, ”Për Prokurimin Publik”, Nenin 11, dhe Nenin 78 pika 2 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku” ka hartuar proces verbalin për hartimin, argumentimin dhe miratimin e kritereve të veçanta për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë:

**Procedura e këtij prokurimi është: Procedure e Hapur, e Thjeshtuar**

**Objekti prokurimit është “Furnizim dhe shërbime me ushqim per mencat”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi për: ushqime të përgatitura – 15894200-3**

**Fondi limit I këtij prokurimi është 7,956,667 (shtatëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) LEKË PA TVSH**

Burimi i financimit: Burimi i Financimit, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Tiranë .

## **Afati I kryerjes së shërbimit do të jetë:**

Afati kohor i ofrimit të shërbimit, do të jetë për një periudhë kohore 12(dymbëdhjetë) muaj/ 1(një) vit/ 308 (treqind e tetë) ditë, duke filluar nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër/ kontratës.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Refruar** nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se *“Afati për pranimin e ofertave në këtë procedure prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi I njoftimit të kontratës.”*

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave është 10 ditë kalendarike.**

**Ofertat do të hapen më 10.05.2024 ora 12:00**

## **Kontrata:**

Në nenin 4, pika 20 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

*“Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni.*

Sa më sipër do të jetë Kontratë Shërbimi.

**Nenkontraktimi:**Nuk lejohet

**Lejohen pagesa të drejtpërdrejta të nënkontraktorit: JO**

Gjuha e prokurimit: **Shqip**

Dokumentet standard të tenderit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

## **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e

nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të të ligjit nr. 162, datë*

*23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr. 285, datë*

*19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/a dhe pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 41, pika 2 dhe pika 4/ a te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

## 2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Kriteri I mësipërm është vendosur në përputhje me Nenin 43, pika 1 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit public ”ku përcaktohet se:**Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

**Gjithashtu dhe në përputhje me Nenin 55, pika 4, të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”ku përcaktohet se:** “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

- Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të konfirmuara nga Organi Tatimor që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilancet i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilancet pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorëve ekonomikë.*

- Vërtetim të lëshuar nga Bashkia ose Drejtoritë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 pranë të gjitha njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

***Shënim:*** Për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartë përmendur.

*Në lidhje me Vërtetimin për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, kërkesa e mësipërme është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar dhe në përputhje me Nenin 76 pika 2 të Ligjit 162 "Për prokurimin publik".*

## **2.2 Kapaciteti teknik dhe profesional**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së kontratës që kontrahohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një nga format e dëshmive si më poshtë:**

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Kriteret e mësipërme janë vendosur sipas përcaktimeve të nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik. Në bazë të këtij kriteri operatorët ekonomikë vërtetojnë eksperiencën në fushën objekt prokurimi dhe autoriteti kontraktor merr garancinë e nevojshme që shërbimi do të kryhet me sukses. Përvoja e operatorit është një element shumë i nevojshëm për autoritetin kontraktor, për të vërtetuar dhe qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e suksesshme të kontratës. Për kontratat e realizuara nga operatori ekonomik, operatori duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar me qëllim të shërbej autoriteti në vlerësimin sa më të qartë të kriterit për eksperiencat e ngjashme.*

### 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate; ISO 22000:2018 certifikatë e sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ose ekuivalente me të (e vlefshme), e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga natyra e objektit të prokurimit shërbime gatimi dhe shpërndarja e tyre, kjo kërkesë është e lidhur ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe është e rëndësishme që operatori ekonomik të ofrojë siguri ushqimore gjatë zbatimit të kontratës.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
  - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
  - Kontratë noteriale huaje (e vlefshme)
- Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
  - Kontratë noteriale qiraje (e vlefshme)

**Shënim 2.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohet plotësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posaçme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është gatimi dhe shpërndarja e ushqimit, pra operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë të ushqimit të miratuar, nga Autoriteti Kontraktor, konform normës bazë të ushqimit, sipas standardeve tekniko-teknologjike dhe për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin e objektit të prokurimit.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e ushqimeve të pergatitura, në pronësi ose me qira ose huapërdorje, sipas tabelës së

meposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targa e mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi/me qira/huapërdorje

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK dokumentacion per mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata noteriale qiraje (e vlefshme) / kontrata noteriale huapërdorje (e vlefshme) mjeti si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit, siguracion mjeti të vlefshëm dhe kolaudim mjeti te vlefshem.

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

**Sqarim:** Ky kriter do te plotesohet nepermjet formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 9 te DST.

Ne zbatim te nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve të gatuar për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është gatimi dhe shpërndarja e ushqimit, pra operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë të ushqimit të miratuar, nga Autoriteti Kontraktor, sipas normës bazë të ushqimit, sipas standardeve tekniko-teknologjike si dhe ta shpërndaj ne ambientet e autoritetit kontraktor konform kërkesave të Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike. Është e nevojshme disponimi i nje mjeti transporti frigoriferik për ruajtjen e nivelit kulinar të ushqimit dhe temperaturën optimale me qellim shmangien e mundësisë për kontaminimin e ushqimit gjate transportit.

**2.3.5**Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e meposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist/Tegnolog ushqimor)	1
2.	Kuzhinier	2
3.	Ndihmes Kuzhinier	2



4.	Punonjes shperndares ushqimesh/Shofer	2
	<b>Total</b>	<b>7 (shtatë)</b>

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

**a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist/Teknolog ushqimor) te paraqitet:**

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist/Teknolog ushqimor
- Kontrate pune perkatese.
- CV ose Libreze pune ose dokumentacion tjetër që verteton eksperincen perkatese. Minimumi 1 (nje) vit pune ne profesion.

**b) Për Kuzhinierin te paraqitet:**

- Diplome ose çertifikatë kualifikiminë përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- CV ose libreze pune ose dokumentacion tjetër që verteton eksperincen përkatëse. Minimumi te kete 1 (nje) vit pune ne profesion.

**c) Ndihmes kuzhinier te paraqitet:**

- Kontrate pune perkatese.

**d) Për punonjësit per shperndarje ushqimi\Shofer,te paraqitet:**

- Kontratë pune perkatese.
- Leje Drejtimi për mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.

- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

**Shënim 4.1:**

Me qëllim garantimin e gjithë perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

**Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.**

**Sqarim:** Ky kriter do te plotesohet nepermjet formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 8 te DST. Ne zbatim te nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162,

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b/c , të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se objektit që prokurohet është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes për realizimin e objektit. Operatori ekonomik duhet të disponojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve, i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të gatitmi dhe shpërndarjes së ushqimit, pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi i kërkuar duhet të jetë i kualifikuar dhe me experience në fushën e objektit të prokurimit.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Shënim:** Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës me autoritetin kontraktor ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, shërbime gatimi dhe shpërndarja e tyre, është e rëndësishme që operatorët ekonomik të jenë vlerësuar nga organtet kompetente që e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur sigurinë ushqimore.

**2.3.7**Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se mundëson transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në vendet e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës dhe se do të jene te gatshem te pergjigjen ne kohe dhe ne vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor per realizimin e sherbimit.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje mevetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbënkusht s’kualifikimi.*

b. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:

